



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 733/ Prot.

Tiranë, më 2/10/2013

Lënda: Rekomandim për kontrolluesin Zyra e Noterisë Hilmie Brahim, Berat

REKOMANDIM

Nr. 29 datë 02/10 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, Zyra e Noterisë Hilmie Brahim Berat.

KONSTATOVA

Në datë 12/09/2013 Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontroll administrativ pranë kontrolluesit, Zyra e Noterisë Hilmie Brahim Berat me objekt;

- Ligjshmëria e mbledhjes, përpunimit të të dhënave personale për subjektet e të dhënave personale "punonjës", sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Nga kontrolli i ushtruar rezulton se kontrolluesi ushtron aktivitet në fushën e profesioneve të lira noter publik në qytetin Berat. Në këndvështrimin e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, gjatë ushtrimit të aktivitetit tuaj merrni cilësinë e kontrolluesit privat, pasi në punën tuaj mblidhni dhe përpunoni të dhëna personale për kategorinë të ndryshme subjektesh të të dhënave personale.

Ligji nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", në nenin 3 përkufizon; "Kontrollues" është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Kontrolli administrativ ndaj jush u shtri vetëm në aspektin e plotësimit të detyrimit ligjor për njoftim pranë zyrës së komisionarit dhe sigurisë së të dhënave personale. Grupi i kontrollit administrativ që ushtroi kontrollin pranë jush ka konstatuar shkelje mospasjen e rregullave për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale, si dhe mosplotësimin e detyrimit ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", shkelje që referojnë në nenet 21 dhe 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008.

Nisur nga relacioni i grupit të kontrollit administrativ, procesverbali i mbajtur nga grupi i kontrollit administrativ për shkeljet e konstatuara, provat bashkëlidhur dhe gjithë argumentet e tjera rreth këtij kontrolli administrativ vlerësoj se; shkeljet e konstatuara nga grupi i kontrollit administrativ në procesverbalin e datës 11/09/2013 qëndrojnë dhe në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 27,28 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjen përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
2. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të kryhet brënda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij rekomandimi.
3. Kontrolluesi Zyra e Notarisë Hilmie Brahimi Berat mbas përmbushjes së këtyre Rekomandimeve mbart detyrimin ligjor për të njoftuar Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Në rast mospërmbushje të këtij Rekomandimi, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas të cilit *”Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”*.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

